

E DREJTA E FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA PËR ARSIM GJITHËPËRFSHIRËS

Faktorët që kontribuojnë në zbatimin e arsimit
gjithëpërfshirës

Mars 2012

E DREJTA E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR ARSIM GJITHPËRFSHIRËS

**Faktorët që kontribuojnë në zbatimin e arsimit
gjithpërfshirës**

Mars 2012

Ky studim është realizuar me mbështetjen e organizatës World Vizion. Mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të organizatës World Vizion

Falenderime

Falenderojmë për mundësinë e realizimit të këtij raporti studimor organizatën World Vizion, si dhe të gjithë pjesëmarrësit (drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore të rretheve Berat, Korçë, Laç) për shkëmbimin e sinqertë të ideve dhe mendimeve lidhur me analizën e faktorëve që përshpejtojnë dhe ngadalësojnë zbatimin në praktikë të procesit të gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe për pasqyrimin transparent të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të kopshteve dhe shkollave në zbatim të këtij procesi.

Pasqyra e lëndës

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Emri i Plotë
PEI	Plan Edukativ Individual
AGj	Arsim gjithpërfshirës
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PAK	Personat me aftësi të kufizuara
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit,
PEI	Plan Edukativ Individual
KMCAP	Komisioni Mjeko Ligjor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
AGJ	Arsim Gjithpërfshirës
SPS	Strategjia e Përfshirjes Sociale
ZA	Zyra Arsimore
AK	Aftësi e kufizuar

I. PËRMbledhje Ekzekutive

Rëndësia e mbrojtjes me ligj të të drejtës për arsim

E drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një e drejtë themelore e tyre, e cila sanksionohet në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare.

Konventa më e re e Kombeve të Bashkuara, "Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, thekson detyrimin e shteteve palë për të njohur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për edukim dhe për ta realizuar këtë të drejtë pa diskriminim, dhe në bazë të mundësive të barabarta. Shtetet palë detyrohen të sigurojnë një sistem edukimi gjithpërfshirës në të gjitha nivelet, të orientuar drejt:

- a). zhvillimit të plotë të potencialit njerëzor, dinjitetit dhe vetvlerësimit; fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor;
- b). zhvillimit të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së personave me aftësi të kufizuara, si dhe aftësive të tyre mendore dhe fizike, deri në potencialin e tyre të plotë;
- c). pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të kufizuara në një shoqëri të lirë.

Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin tonë arsimor është i lidhur ngushtë dhe mund të shihet nga këndvështrimi i nismës ligjvënese të shtetit, gjë që në thelb shpreh detyrimin e shtetit për kujdesin ndaj këtyre fëmijëve në nivelin më të lartë ligjor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë siguron "mbrojtjen nga diskriminimi mbi bazën e gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare e filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore" dhe përcakton se mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi bëhet për shkak të gjendjes së tyre sociale. Kjo Kushtetutë sanksionon arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve:

- e). përkujdesjen dhe ndihmën për personat me aftësi të kufizuara;
- f). riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të njerëzve me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës

Konventa e të drejtave të fëmijëve (1990) mbron tërësisht të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kryesisht të drejtën e fëmijëve për të mos qënë preh dhe e të drejtës për të qënë të barabartë me fëmijët e tjerë, të drejtën e mosdiskriminimit etj.

Duke u bazuar në Konventat Ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdo nxënës ka të drejtë të shkollohet në një sistem të caktuar arsimor. Në zbatim të këtij parimi, çdo sistem arsimor është i detyruar të përfshijë të gjithë nxënësit në ndjekjen e arsimit të detyruar. Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare.

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë gëzojnë të drejta të barabarta për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit që përcakton ligji, pavarësisht nga gjendja shoqërore, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik.

E drejta për arsim, e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një e drejtë themelore e tyre, e cila sanksionohet në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës sanksionon detyrimin e shtetit për të njohur të drejtën për arsim me synimin për arritjen e kesaj të drejtë mbi baza barazie për të gjithë fëmijët duke e bërë arsimin bazë të detyruar, të arritshëm dhe të çliruar nga detyrimet financiare për të gjithë. Ky ligj detyron shtetet nënshkruese të sigurojnë që arsimimi i fëmijëve të orientohet përkundrajt zhvillimit të personalitetit të fëmijës, talenteve dhe aftësive mendore e fizike për të arritur potencialin e tyre të plotë.

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës theksohet e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar si të gjithë fëmijët e tjerë dhe në përputhje me kapacitetet e tyre mendore e fizike. Po kështu, një ndër objektivat e Strategjisë Kombëtare për personat me Ak, është: "Të sigurohet

mundësia e arsimimit për të gjithë fëmijët me AK, duke i dhënë prioritet arsimit gjithëpërfshirës”.

Në këto kushte, është detyrë e institucioneve arsimore që të hartojnë dhe zbatojnë politika arsimore me objektiva dhe detyra të përcaktuara qartë, të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e mundësive të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të qënë pjesë aktive e procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies në shkolla.

Qeveria shqiptare dhe organizmat ndërkombëtare prej kohësh kanë pranuar se sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Në këto kushte i është kushtuar një rëndësi e madhe përfundimit të statusit të arsimit shqiptar duke synuar shndrrimin e shkollave në shkolla për të gjithë fëmijët. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një angazhim intensiv profesional brenda institucioneve arsimore, si dhe për të garantuar një sistem arsimor të barabartë për të gjithë nxënësit.

Për të realizuar misionin e arsimit të të gjithë fëmijëve pa asnjë dallim, një rëndësi të veçantë merr mbështetja në traditat e arritjet e shkollës sonë kombëtare, në përputhje me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, që respekton të drejtat e fëmijëve dhe të të rriturve. Shkolla përfaqëson një institucion të organizuar dhe të specializuar për arsimimin e çdo fëmije. Nevoja për krijimin e shkollës ka lindur në një periudhë të caktuar kohore dhe historike, për t'i ardhur në ndihmë edukimit të brezave dhe zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik të një vendi. Shkolla lind dhe zhvillohet si një qëndër mësimi shumëplanësh, që prodhon shërbime arsimore fleksible dhe cilësore për të gjithë nxënësit, në bashkëpunim të ngushtë me organizmat të tjerë shoqërorë.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga format më të mira të arsimimit për të gjithë fëmijët.

Është e drejta e çdo fëmije të arsimohet në shkolla dhe të trajtohet me dinjitet. Mësimdhënia duhet t'i përshtatet specifikave, nevojave dhe mundësive të çdo nxënësi, Shkolla është e njëjtë për të gjithë fëmijët dhe për vijimin e saj, të gjithë kanë shanse të barabarta, pavarësisht nga aftësitë që ka gjithësecili.

Veprimtaria mësimore - edukative në shkollën shqiptare, brenda dhe jashtë saj, realizohet në përputhje me:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, nr. 7952, datë 21.06.1995, me shtesat dhe ndryshimet e bëra në ligjin nr. 8381, datë 30.07.1998.
3. Legjislacionin tjetër në fuqi.
4. Dokumentet ndërkombëtare ku aderon Republika e Shqipërisë.

Sistemi arsimor shqiptar nuk mund të mbetet jashtë ndryshime të përgjithshme që ndodhën në të gjitha fushat e tjera të shoqërisë shqiptare. Zhvillimet e viteve të fundit, problemet e shumta shoqërore, politike dhe ekonomike që shoqërojnë jetën e përditshme, kanë ndikuar duke sjellë ndryshime në vazhdimësi edhe në sistemin tonë arsimor; në drejtim të përmbajtjes, strukturës dhe shërbimeve që ai ofron. Sistemi arsimor është përfshirë në reforma pasi dhe marrëdhëniet shoqërore, ekonomike, politike kanë ndryshuar vazhdimisht Përballë këtyrë ndryshimeve, institucionet arsimore kanë reflektuar, duke krijuar mundësi që të gjithë fëmijët të arsimohen në bazë të veçorive dhe kapaciteteve të tyre. Ka qënë gjithmonë aktuale nevoja për një konceptim të ri dhe bashkëkohor lidhur me përmbajtjen e punës, metodologjinë e mësimdhënies, përshtatjen e mjedisit, organizimin dhe planifikimin e shumë elementëve edukativë në procesin e arsimit, në mënyrë që edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin pjesë plotësisht në jetën e komunitetit shkollor si anëtarë të vlefshëm të këtij komuniteti.

Strukturat arsimore dhe qëndrimet e ndërtuara për gati pesë dekada më parë bashkekzistojnë me modelet e reja të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e arsimit bazë, të prezantuara pas viteve 1990. Në këtë kuadër, edhe shoqata 'MEDPAK', në bashkëpunim me Organizatën "World Vision" ka përgatitur raportin studimor: Vlerësimi faktorëve që kontribuojnë për të zbatuar në praktikë arsimin gjithpërfshirës.

Studimi ka synuar identifikimin e njohurive, qëndrimeve, sjelljeve dhe eksperiencave të punonjësve të arsimit, prindërve dhe bashkëmoshatarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara lidhur me zbatimin në praktikë të arsimit gjithpërfshirës. Ky studim ka synuar gjithashtu identifikimin e mangësive, pengesave dhe mundësive në zbatimin e legjislacionit për të bërë të mundur arsimimin e çdo fëmije me apo pa aftësi të kufizuara.

Objektivat

- Identifikimi i njohurive, nevojave dhe aftësive të punonjësve të arsimit për të zbatuar në praktikë arsimin gjithpërfshirës.
- Identifikimi i mangësive, pengesave dhe mundësive në zbatimin e legjislacionit për të siguruar arsimim për të gjithë fëmijët.

Ky raport do të shërbejë si një bazë për të sugjeruar përmirësimet në legjislacionin aktual dhe zbatimin e tij, ndërgjegjësimin e punonjësve të arsimit mbi rëndësinë e zbatimit në praktikë të arsimit gjithpërfshirës, përmirësimin të infrastrukturës shkollore, si dhe adresimit të nevojave psiko - sociale dhe arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Pyetjet e studimit:

1. A kanë punonjësit e arsimit njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zbatuar në praktikë arsimin gjithpërfshirës?
2. Cilat janë pengesat në zbatimin e procesit të gjithpërfshirjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin aktual arsimor shqiptar?

Ky raport do të shoqërohet gjithashtu edhe me rekomandime, të cilat do t'i shërbejnë përfshirjes së fëmijëve me AK në kopshtet e shkollat e arsimit bazë, adresimit të problematikave dhe nevojave të tyre në këtë fushë, si dhe nxitjes së respektimit të të drejtave të këtyre fëmijëve për të përfituar nga një arsimim sa më cilësor.

Ky raport synon të paraqesë nga njera anë rëndësinë e zbatimit në praktikë të arsimit gjithpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri si mjeti i vetëm dhe i përshtatshëm që siguron realizimin e objektivit për të bërë të mundur arsimim e të gjithë fëmijëve dhe nga ana tjetër ai paraqet rëndësinë e shndrrimit të kopshteve e shkollave shqiptare në kopshte e shkolla gjithpërfshirëse.

Raporti është realizuar si një ndërthurje e elementeve teorikë me ato empirikë. Nga njera anë është paraqitur një analizë e dokumentave që pasqyrojnë të dhënave nga zbatimi i arsimit gjithpërfshirës dhe nga ana tjetër janë analizuar dhe shqyrtuar mendimet, besimet dhe perceptimet e të intervistuarve (punonjës arsimi, nxënës, dhe punonjës të institucioneve) mbi rëndësinë e zbatimit të arsimit gjithpërfshirës, pengesave dhe sfidave në zbatim të këtij procesi.

2. HYRJE

Sigurisht që praktikat gjithpërfshirëse në fushën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendin tonë janë produkt i zhvillimit të procesit të arsimit special për këta fëmijë, ndër vite, duke ruajtur dhe trashëguar tiparet më të mira, duke përqafuar përvojat pozitive të shoqërive europiane, si dhe duke u influencuar e ndikuar fuqimisht nga eksperinca ndërkombëtare. Edhe arsimit gjithpërfshirës ka historinë e vet të zhvillimit dhe të rritjes në vetvete, në lidhje me legjislacionin, menaxhimin organizativ dhe zhvillimin e përmbajtjes/kurrikulës.

Historia e gjatë e veçimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet, (në institucione dhe shkolla të posaçme për ta, në rradhët e shoqërisë), ka krijuar pengesa për zbatimin në praktikë të arsimit gjithpërfshirës, duke bërë që ai të mos vijë si një evolucion i natyrshëm bazuar në një eksperincë të mëparshme apo si një nevojë dhe domosdoshmëri. Ndryshe nga vendet e tjera perëndimore, ku zhvillimi i arsimit gjithpërfshirës ishte produkt i pjesëmarrjes aktive të vet njerëzve me aftësi të kufizuara, i prindërve të tyre dhe i profesionistëve, në Shqipëri influenca dhe imitimi ndërkombëtar ka qënë faktori kryesor kontribues në drejtim të këtij zhvillimi. Të gjitha ndryshimet kryesore kanë ndodhur përmes veprimtarive administrative, dhe nuk kanë qënë produkt i presionit dhe ndikimit të njerëzve të përfshirë direkt ose indirekt në të. Panorama e arsimit gjithpërfshirës sot reflekton si qëllimet edhe realitetin e zbatueshmërisë së tij në kopshtet e shkollat shqiptare.

Në lidhje me praktikën e arsimit gjithpërfshirës, nuk ka dokumenta sistematike për të gjitha projektet që kanë zbatuar modele të këtij lloji arsimimi ose iniciativat në shkollat shqiptare në lidhje me këtë, duke e bërë nxjerrjen e konkluzioneve veçanërisht të vështirë. Kjo mungesë e të dhënave sistematike, të vlefshme dhe të besueshme përse i përket arsimit gjithpërfshirës në vendin tonë i vendos kufij çdo studimi vlerësues të tërësishëm, derisa të dhënat e vetme të disponueshme vijnë prej artikujve të rastësishëm apo takime e bisedave joformale.

Historia e arsimit gjithpërfshirës megjithëse e shkurtër është e mbushur me një mori ngjarjesh e procesesh. Megjithëse tashmë arsimit gjithpërfshirës konsiderohet si një e drejtë morale e ligjore dhe si një filozofi progresive, përsëri zbatimi i tij në praktikë është i detyruar t'i përmbahet detyrimeve të shumta të imponuara nga realiteti mbizotërues i shoqërisë shqiptare. Flitet shumë për të drejtat e barabarta që kanë të gjithë fëmijët në fushën e arsimit, për përfshirjen e barabartë të të gjithë fëmijëve në aktivitetet e përbashkëta, por këto nuk garantojnë zbatimin me sukses të arsimit gjithpërfshirës. Ka disa faktorë të cilët nuk kontrollohen, drejtohen apo planifikohen në mënyrë të efektshme siç mund të jenë: numri i lartë i nxënësve në klasa, qëndrimet stigmatizuese e dhe paragjyquese të bashkëmoshatarëve, prindërve të tyre dhe punonjësve të arsimit, pritshmëritë e ulëta të mësuesve për progresin dhe arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Të gjitha këto kufizime herë serioze dhe herë të tjera më të lehta për t'u kapërcyer karakterizojnë tipin dhe llojin e arsimit gjithpërfshirës në Shqipëri dhe gjithashtu përcaktojnë nivelin e suksesit në zbatimin e tij.

Të gjitha zhvillimet kryesore në fushën e arsimit gjithpërfshirës janë prezantuar nga qeveria si një përpjekje për të adresuar nevojat e një grupi të marginalizuar siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe si një përgjigje ndaj pritshmërive politike dhe jo si një planifikim sistematik dhe afatgjatë.

Por pavarësisht të gjithë këtyre kufizimeve arsimit gjithpërfshirës është një realitet në ditët tona. Ky realitet i vërtetë nxit prirjet e reja dhe zgjon nevojën për identifikimin e çështjeve kyçe që duhet të zgjidhen nga institucionet shtetërore që operojnë në fushën e arsimit.

Është fakt që fëmijët me aftësi të kufizuara, përbëjnë një pakicë të vogël krahasuar me popullatën e gjerë të fëmijëve, por ata duhen konsideruar dhe respektuar, sikurse çdo fëmijë tjetër. Sipas të dhënave të marra nga zyra e Observatorit mund të themi se: janë gjithsej 17.786 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 4776 fëmijë janë të grupmoshës 0-6 vjeç, 8845 fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç ndërsa 4165 fëmijë të

grupmohës 15-18 vjeç. Përsa i përket ndarjes gjinore janë 7782 femra dhe 7764 meshkuj. Fëmijë që duhet të frekuentojnë arsimin parashkollor llogariten të jenë 2289, ndërsa 5477 fëmijë duhet të frekuentojnë arsimin 9-vjeçar, dhe 1356 fëmijë duhet të ndjekin arsimin e mesëm.

(Duhet theksuar se sigurimi i këtyre të dhënave ka qënë mjaft i vështirë për faktin se në vendin tonë mungojnë të dhënat e sakta zyrtare për këtë kategori fëmijësh ose herë pas herë informacioni është konfuz dhe i mbivendosur. Këto të dhëna janë marrë nga burime pranë Shërbimit Social Shtetësor).

Nëse i referrohemi të dhënave të mbledhura nga specialistë pranë MASH-it, rezulton se në vitin 2010 numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, të përfshirë në shkolla në rang vendi ishte 2611 fëmijë, nga të cilët 699 prej tyre kishin aftësi të kufizuara pamore dhe 456 aftësi të kufizuara fizike (lëvizore) dhe pjesa tjetër aftësi të kufizuara mendore, probleme dëgjimi, të foluri, çrregullime zhvillimi etj si këto. Duhet theksuar se këto të dhëna nuk janë zyrtare. Nëse i referohemi klasifikimit të aftësisë së kufizuar, bazuar mbi këto të dhëna statistikore, mund të themi se në vendin tonë nuk ka komisione të specializuara, të ngritura mbi bazë shkolle, DAR-i, bashkie, komune, të cilat të përcaktojnë mbi bazë të kritetereve profesionale aftësitë e fëmijëve dhe mundësitë e tyre për t'u arsimuar. Në këtë kuadër, vlen të përmendim iniciativën e Shoqatës "MEDPAK", e cila në bashkëpunim me Save the Children dhe MASH në vitet 2011 - 2012, ka bërë të mundur përmes zbatimit të një projekti pilot, ngritjen dhe konsolidimin e dy ekipeve multidisiplinare në rajonet Korçë dhe Vlorë. Këto grupe vlerësimi me bazë DAR, vlerësojnë dhe adresojnë nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qytetet përkatëse. Në përbërje të tyre janë përfaqësues nga DAR-i, Bashkia, Shëndeti publik dhe shërbimi psiko-social.

Duke e konceptuar fëmijën me aftësi të kufizuara si një individualitet me cilësi dhe potenciale të mëdha, pavarësisht nga çrregullimet, duhen krijuar mundësi që fëmija të riaftësohet në të gjitha fushat e zhvillimit. Çdo fëmijë me aftësi të kufizuara, duhet të jetojë mes fëmijëve të tjerë që të kuptojë dhe të kuptohet. Asnjë metodë, asnjë teknikë dhe asnjë ushtrim nuk mund të zëvendësojë raportin njerëzor, prandaj duhet mbështetur integrimi dhe gjithpërfshirja e tyre në arsim. Një fëmijë me aftësi të kufizuara i integruar apo i gjithpërfshirë në sistemin arsimor, pikë së pari është një sfidë, që duhet të përmbushet deri në fund, është një përgjegjësi për të gjithë sepse ai duhet të shndërrohet në një individ të aftë për t'u rritur, zhvilluar dhe për të patur raporte me të tjerë. Duke e konsideruar zhvillimin e fëmijës shumë dinamik dhe kompleks, arrijmë në përfundimin se çdo fëmijë ka nevojë në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme për edukim, arsimim dhe socializim pranë bashkëmoshatarëve të tij në të njëjtat kopshte e shkolla. Me zhvillimin e përgjithshëm të vendit edhe këta fëmijë dhe familjet e tyre, kanë përfituar nga përparimet dhe ndryshimet njësoj si edhe të tjerët. Shqipëria është një nga nënshkrueset e para të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe vendi është angazhuar të zhvillojë mirqënieën e gjithë fëmijëve të vendit. Një ndër kërkesat e shtruarra qartë për vendet që kërkojnë të antarësohen në Komunitetin Europian është edhe përmbushja e të drejtës për arsimim e të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj dallimi pavarësisht nga aftësia e kufizuar apo nevojat speciale që ata kanë.

Dy janë arsyt kryesore përse këta fëmijë duhet të mësojnë në shkollat e zakonshme me bashkëmoshatarët. E para, sepse shoqërizimi nxit zhvillimin e tyre dhe e dyta, sepse nxjerr në pah mundësitë që kanë. Shoqërizimi me pjesën tjetër të shoqërisë është aspekti i mohuar në edukimin special, prandaj këtij aspekti i është dhënë rëndësi parësore për arritjet e fëmijëve me AK.

- Gjithpërfshirja është një proces nëpërmjet të cilit arrihet që të gjithë fëmijët të përfshihen dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin mësimor.
- Gjithpërfshirja është një term i lidhur ngushtë me diversitetin. Merr në konsideratë ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet fëmijëve: moshën, gjininë, pasurinë, aftësinë e kufizuar, kulturën, fenë, vendbanimin, statusin shëndetësor, social dhe etik.
- Gjithpërfshirje do të thotë njohje dhe pranim i ndryshimeve mes fëmijëve dhe përdorim pozitiv i këtij fakti për të siguruar një zhvillim dhe edukim cilësor për të gjithë ata.
- Realizimi i procesit të gjithpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim bën të mundur:
 - Krijimin e një "kulturë" që nënkupton vlerësimin, pranimin dhe mbështetjen e diversitetit të fëmijëve.

- Reduktimin e stigmës dhe të paragjyqimeve që ekzistojnë për arsimimin dhe mundësitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë.
- Krijimin e besimit se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë kapacitete dhe aftësi që mund të çojnë drejt asimilimit të programit mësimor brenda mundësive të tyre.
- Ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi arsimor bashkëkohor, pjesë e të cilit do të jenë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Përmes realizimit të arsimit gjithëpërfshirës fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mundësi të mësojnë në të njëjtat shkolla sikurse edhe bashkëmoshatarët e tyre. Ata mësojnë dhe zhvillohen si të gjithë fëmijët e tjerë, pavarësisht nga ndryshimet individuale që ata mund të kenë. Kanë shanse të zhvillojnë aftësi dhe kapacitete individuale, duke dalë në pah vlerat e tyre. Në shkolla gjithëpërfshirëse fëmijët me AK ndjehen të respektuar, të vlerësuar dhe të konsideruar për atë çka përfaqësojnë, për kapacitetet që disponojnë, dhe për vlerat që mbartin
- Në raport me fëmijën me aftësi të kufizuara, shkolla duhet konsideruar si një nyje sociale, si një pikë takimi që e vendos fëmijën përballë një realiteti, i cili në një mënyrë ose tjetër, do të sjellë transformim, ndryshim pozitiv në jetën e fëmijës dhe familjës së tij dhe të komunitetit ku ai jeton.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet "të hyjnë" në shkollë "për t'u kuptuar dhe jo për t'u studjuar" për "t'u ndihmuar dhe jo për t'u venë në disiplinim apo rregjim të forte". Shkolla është "pikë kyçe" dhe "nyjë sociale" për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Brenda shkollës krijohet dhe strukturohet "një lidhje e veçante" ndërmjet komunitetit shkollor dhe fëmijës me aftësi të kufizuara. Kjo lidhje i jep vlerë dhe rëndësi "procesit të arsimimit dhe socializimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në jetën shkollore dhe atë sociale. Ky socializim në shkollë, me vonë ndërton një shoqëri për të gjithë

Në këtë mënyrë funksioni i shkollës çon drejt nevojës për të krijuar "njerëz", për të zhvilluar individë dhe për të rritur personalitete edhe pse në pamje të parë duken "të ndryshëm" apo "të veçantë". Ky proces nuk mund të realizohet pa mbështetjen shumëplanëshe të organizmave qeveritarë, pa pjesëmarrjen e koordinuar të familjes dhe të ambientit shoqëror ku fëmija jeton, pa tolerancën dhe mbështetjen e shoqërisë dhe komunitetit.

Janë identifikuar tre faza në zhvillimin e praktikës së arsimit gjithëpërfshirës

1. Përfshirja e fshehur ose e padukshme. Rastet e para të dokumentuara të arsimit gjithëpërfshirës e kanë zanafillën në vitin 1996 atëherë kur fëmijët me prapambetje mendore të lehtë apo dhe të mesme u përfshinë në kopshte e shkolla. Këto raste ishin të veçanta dhe ishin produkt i iniciativave personale të edukatorëve nismëtare. Ato paraprinë çdo iniciativë shtetërore dhe ligjore dhe përfaqësonin përpjekjet individuale. Fatkeqësisht shumë pak është dokumentuar për sistemin dhe rezultatet e këtyre përpjekjeve.

2. Projektet nga OJF-të ndryshme shënojnë fazën e dytë në historinë e zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës. Vlen të theksohet se projekte të ndryshme të iniciuara nga OJF-të ndryshme u implementuan në kopshte e shkolla të rajoneve të ndryshme në periudhën në vazhdim. Ato filluan të adresonin edhe nevojat e fëmijëve që vinin nga grupet e deprivuara shoqërore.

3. Gjatë fazës të tretë që përkon me krijimin e një kornize të plotë ligjore në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës, duke filluar që në vitet e para pas përmbyesjes së rregjimit komunist. Si rezultat i kësaj nisme përpjekjet për arsimin gjithëpërfshirës kanë lulëzuar dhe kanë fituar mbështetjen e plotë të mekanizmave shtetërorë dhe institucioneve qeveritare. Shumica e këtyre përpjekjeve janë kufizuar në zonat e mëdha urbane, duke krijuar mangësi dhe boshllëqe në zonat rurale dhe rajonet përreth tyre. Gjatë kësaj faze filozofia e arsimit gjithëpërfshirës ka pasur formate dhe mënyra të ndryshme të shprehjes dhe implementimit të tij.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë, në tre rajone, në të cilat MEDPAK në bashkëpunim me Save the Children, ka zbatuar ndër vite projekte për arsimin gjithëpërfshirës.

	Fëmijë gjithsej të përfshirë në projekt	Femra	Meshkuj	Fëmijë në kopshte	Fëmijë në shkollë	Fëmijë që arsimohen me PEI	Fëmijë me AK	Fëmijë me VN
Tre rajone	121	42	79	40	81	77	71	50
Korçë	61	23	38	15	46	42	40	21
Gjirokastrë	32	8	24	19	13	17	3	29
Vlorë	28	11	17	6	22	18	28	0

Gjithashtu vlen të përmendim se në kuadër të zbatimit të këtyre projekteve është përmirësuar ndjeshëm edhe infrastruktura e shkollave dhe kopshteve të përfshira në projekt në qytetet Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë; për t'i bërë ato të aksesueshme për të gjithë fëmijët. Kështu në qytetin e Korçës janë ndërtuar rampa në shkollën "Asdreni" dhe në kopshtin Nr 2 . Në qytetin e Vlorës janë ndërtuar rampa dhe janë përshtatur tualetet në shkollat "I Qemali", "Lef Sallata", Teli Ndini " dhe në kopshtin Nr 9. Në qytetin e Gjirokastrës janë ndërtuar rampa në shkollat: "Urani Rumbo", "Çajupi", "Koto Hoxhi" dhe në kopshtet Nr 5, Nr 6 dhe Nr7.

3. METODOLOGJIA

Për realizimin e studimit u përdor një metodologji e kombinuar e llojit cilësor dhe sasior. Përpunimi dhe paraqitja e rezultateve të metodave të ndryshme, që janë përdorur përgjatë këtij studimi, lënë me shumë vend për mendim, reflektim dhe objektivitet. Të dhënat krahasuese dhe perceptimi i aktorëve të ndryshëm në realizimin e procesit të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me AK ka qenë një nga pikat interesante të studimit.

Subjektet në studim

Subjektet në studim ishin punonjës arsimit dhe përfaqësues të drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore që mbështesin procesin e zbatimit në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës në qytetet Korçë, Berat, Tiranë dhe Laç pa dallim seksi dhe moshe. Të përfshirë në studim ishin gjithashtu edhe bashkëmoshatarët e fëmijëve me ak që mësojnë së bashku në të njëjtat shkolla. Realizimi i pyetësorëve është bërë në ambjentet e institucioneve arsimore

• **Komponenti sasior:** konsistoi në administrimin e dy pyetësorëve të strukturuar që i'u drejtuan këtyre punonjësve, prindërve dhe fëmijëve në rajonet e përfshira në studim. U intervistuan 75 mësuesë, 88 nxënës, përzgjedhja e të cilëve u bë si më poshtë:

- 20 mësuesë në qytetin e Korçës
- 25 në Tiranë
- 9 në qytetin e Laçit
- 21 në qytetin e Beratit

Pyetësori për punonjësit e arsimit synonte të mblidhte informacion nga punonjësit e arsimit lidhur me njohuritë, qëndrimet dhe sjelljen e tyre lidhur me zbatimin në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës, burimeve nga të cilat ata kishin marrë informacionin e duhur për rëndësinë dhe dobishmërinë e zbatimit të këtij procesi, përdorimit të teknikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse.

Informacionet e marra nga pyetësori që ju shpërnda nxënësve në disa prej shkollave të rajoneve të lartpërmendura kishte të bënte me mënyrat e qëndrimit dhe sjelljes së fëmijëve ndaj shokëve të tyre me AK.

Pyetësorët i'u drejtuan të intervistuarëve gjatë periudhës shkurt - mars 2012.

Të dhënat sasiore të mbledhura u hodhën në kompjuter dhe u analizuan në programin statistikor SPSS (*Statistical Package for Social Sciences, version 17.0*).

Pjesa deskriptive konsistoi në raportimin e frekuencave (numrat dhe përqindjet përkatëse) për variablet (ndryshorët) kategorike dhe raportimin e madhësive të prirjes qendrore dhe madhësive të dispersionit për variablet numerike.

• **Komponenti cilësor**

Për të bërë të mundur marrjen e informacioneve të hollësishme mbi nivelin e njohurive dhe kompetencave, aftësive dhe kapaciteteve profesionale të punonjësve të institucioneve të DAR-ve dhe ZA-ve në qytetet e lartpërmendura, u përgatitën intervista gjysëm të strukturuar. Përmes këtyre intervistave gjysëm të strukturuar me përfaqësues të drejtorive përkatëse u vlerësuan, analizuan dhe interpretuan përjasjet, këndvështrimet, idetë dhe sugjerimet e këtyre punonjësve lidhur me zbatimin në praktikë të arsimit gjithpërfshirës në rajonet e tyre.

Subjektet në studim

Subjektet në studim ishin përfaqësues të institucioneve arsimore parashkollore dhe shkollore, përfaqësues të drejtorive dhe zyrave arsimore në rajonet Korçë, Tiranë, Berat, Lezhë, dhe nxënës të këtyre institucioneve.

Përmes informacioneve të marra nga intervistat e zhvilluara, dhe pyetësorët e strukturuar është dhënë një tablo e qartë e çështjeve që lidhen drejtpërsëdrejti me implementimin e praktikave dhe metodave gjithpërfshirëse në shkollat shqiptare.

Intervistimi i aktorëve kryesorë, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në planifikimin, menaxhimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve që lidhen drejtpërsëdrejti me arsimin gjithpërfshirës kanë qenë një burim i rëndësishëm për studimin në fjalë. Këto intervista kanë qenë të rëndësishme, pasi kanë shërbyer, jo vetëm si si një burim i drejtpërdrejtë informacioni, por kanë mbartur dhe një sens analitik për çdo informacion të grumbulluar. Të gjithë personat e intervistuar në këtë studim, kanë pasur eksperiencë disa vjeçare në fushën e arsimit gjithpërfshirës, duke na ofruar kështu një panoramë të plotë, nga këndvështrimi i tyre prej profesionistësh.

4. INTERPRETIMI I INTERVISTAVE DHE ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e të dhënave cilësore

Nga vlerësimi i kryer mbi bazën e intervistave me persona kyç në drejtoritë dhe zyrat arsimore në rajonet e lartpërmendur, u vërejtën qartë mungesa dhe problematika lidhur me zbatimin e politikave dhe ligjeve ekzistuese që favorizojnë zbatimin në praktikë të arsimit gjithpërfshirës, probleme që kanë të bëjnë me vizionin dhe strategjinë e sistemit arsimor shqiptar në drejtim të realizimit të procesit të gjithpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara; probleme që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe trajnimin e punonjësve të arsimit në drejtim të zbatimit të praktikave dhe metodave gjithpërfshirëse, si dhe nevoja për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve multidisiplinare mbi bazë shkolle dhe DAR-i për të vlerësuar dhe monitoruar punën me fëmijët me ak, bashkëpunimi shkollë familje si një nga pikat kryesore për realizimin e këtij procesi, si dhe krijimi i mundësive për t'a shndërruar shkollën në një shkollë për të gjithë fëmijët.

Analiza dhe interpretimi i informacioneve të marra nga intervistat gjysëm të strukturuar me personat kyç lidhur me perceptimet e tyre rreth procesit të gjithpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pengesave dhe çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me sfidat me të cilat përballen ky proces, me rolet dhe detyrat e drejtorive arsimore në këtë proces, përgjegjësitë e punonjësve të arsimit dhe institucioneve të tjera shetërore që punojnë në këtë fushë, çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërsektorial si çelësi që garanton mbarëvajtjen e këtij proces, etj.

A. Intervista me punonjësen e drejtorisë arsimore të qytetit të Tiranës. Ajo evidenton çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të procesit të gjithpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sipas saj zbatimi në praktikë i këtij procesi ndeshet me një numër të madh vështirësish që kanë të bëjnë me: numrin e lartë të nxënësve në klasa, i cili varion nga 32 - 38 nxënës për klasë (në këto kushte përfshirja e një fëmije e me aftësi të kufizuara në klasat e arsimit bazë bëhet e vështirë), mungesa e kualifikimeve të duhura të punonjësve të arsimit është një tjetër sfidë. Edhe qarkullimi i kuadrove që punojnë në mësimdhënie i shtohet listës së problemeve me të cilat ndeshet ky proces. Ajo tregon se mungesa e një klime pranuese e mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara përbën një tjetër vështirësi që ngadalëson zbatimin e këtij procesi. Këndvështrimi i saj për arsimin gjithpërfshirës konsiston në krijimin e një sistemi arsimor që krijon mundësi për të gjithë fëmijët të frekuentojnë shkollën pa asnjë dallim, ose pa i veçuar ata në shkolla speciale. Ajo shprehet se ende tek mësuesit vërehet një qëndrim negativ përkundrejt arsimit gjithpërfshirës, ose ata nuk shfaqin apo nuk mbajnë qëndrime pozitive ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara. Shumica e tyre nuk ndjehen kompetentë për të mësuar nxënësit me aftësi të kufizuara në klasat e tyre të arsimit të rregullt bazë. Metodatat e mësimdhënies që përdorin mësuesit janë të njëjta për të tërë klasën dhe pothuajse nuk ka fare individualizime apo përshtatje për nxënësit me nevojat të veçanta arsimore.

B. Nga intervista e realizuar me punonjësen e drejtorisë arsimore të qytetit të Korçës theksohet rëndësia dhe domosdoshmëria e zbatimit në praktikë të procesit të gjithpërfshirjes në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si një mjet i favorshëm që krijon mundësi që të gjithë fëmijët të marrin pjesë në procesin mësimor. Ajo shprehet se ky proces është shumë i rëndësishëm jo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara, por edhe për fëmijët e tjerë, pasi ndikon fuqishëm në rritjen e edukimit qytetar të tyre, duke i bërë ata më pranues, më tolerantë dhe më shumë ndihmues ndaj bashkëmoshatarëve të tyre me AK. Sipas saj një ndihmë të madhe në këtë proces kanë dhënë organizatat joqeveritare si Save the Children, e cila ka mbështetur përmes projekteve të ndryshëm zbatimin e këtij procesi. Ai mendon se ndonjëherë pritshmëritë e mësueseve për arritjet, nivelin e përvetësimit të programit mësimor, si dhe për aftësitë dhe kapacitetet e fëmijëve me AK bëhen shkak i nospërfshirjes aktive të tyre në procesin mësimor. Përsa i përket çështjeve që lidhen me kurrikulën arsimore, ajo thekson se mungesa e fleksibilitetit të saj krijon shumë vështirësi në përfshirjen e të gjithë fëmijëve në procesin mësimor. Ajo ka përmendur si një faktor pozitiv që ka ndihmuar në realizimin e këtij procesi, angazhimin e punonjësve të shërbimit psiko - social në shkolla dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit të mësuesëve me prindërit e këtyre fëmijëve. Ajo shton gjithashtu se edhe ndërtimi i disa rampave dhe përshtatja e tualeteve që MEDPAK dhe Save the Children ka në realizuar në disa prej kopshteve e shkollave të qytetit kanë rritur dukshëm aksesin e fëmijëve me AK drejt institucioneve arsimore.

C. Në intervistën e zhvilluar me punonjësen e drejtorisë arsimore të qytetit të Laçit identifikohen disa arsye, të cilat sipas saj shpjegojnë moszbatimin në praktikë të procesit të gjithpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ajo prezanton disa problematika duke i renditur ato si shkaqe të moszbatimit në praktikë të arsimit gjithpërfshirës:

- Mungesa e mësueseve ndihmëse në klasat e arsimit bazë;
- Mungesa e bashkëpunimit ndërsektorial;
- Mungesa e bashkëpunimit shkollë - familje;
- Mungesa e ndërgjegjësimit të punonjësve të arsimit, prindërve dhe komunitetit për të kuptuar dhe pranuar rëndësinë e zbatimit në praktikë të arsimit gjithpërfshirës;
- Mungesa e profesionalizmit të stafit që merret drejtpërsëdrejti me mësimdhënien e fëmijëve me aftësi të kufizuara në drejtim të identifikimit të nevojave të tyre dhe adresimit në mënyra të përshtatshme të këtyre nevojave;
- Mos zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues në këtë fushë.
- Ekzistenca e paragjyqimeve dhe nivelit të lartë të stigmës që ekziston për këta fëmijë;
- Ndërtesa shkollash jo të përshtatura edhe për fëmijët me AK

D. Në intervistën e zhvilluar me punonjësen e drejtorisë arsimore të qytetit të Beratit

identifikohen një sërë faktorësh pozitiv që sipas mendimit të saj kanë luajtur një rol të rëndësishëm në implementimin me sukses të procesit të gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve me AK:

- Realizimi i ndërhyrjes së hershme si kusht paraprak që krijon mundësi për të siguruar përfshirjen e fëmijëve në institucionet arsimore;
- Reduktimi i stigmës dhe paragjykitimit për fëmijët me AK si rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të mësuesëve, drejtuesëve, prindërve, komunitetit shkollor dhe shoqërisë.
- Mbështetja e prindërve të fëmijëve të tjerë;
- Fuqizimi i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ushtruar presion mbi institucionet arsimore për regjistrimin dhe pranimin e fëmijëve me ak në të njëjtat kopshte e shkolla sikurse dhe fëmijët e tjerë;
- Zbatimi i praktikave gjithëpërfshirëse në institucionet parashkollore për t'i hapur rrugë procesit të përfshirjes së fëmijëve me AK në ciklet e tjera të shkollimit të tyre;
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për të siguruar akses të barabartë për të gjithë fëmijët

Ajo shprehet se arsimi gjithëpërfshirës në nivelin parashkollor është më i menaxheshëm dhe më i pranueshëm se sa në nivelet arsimore më të larta. Fëmijët e kopshteve janë më të hapur dhe pranues të luajnë dhe të mësojnë së bashku, mësueset e kopshtit janë më të përfshira në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara. Më tej ajo nuk harron të përmend se si rezultat i ndërhyrjeve të strukturuar që janë pilotuar ndër vite në formën e projekteve për arsimin gjithëpërfshirës në qytetin e Beratit, nga organizata "Save the Children", një numër i konsiderueshëm fëmijësh me ak janë aktualisht pjesë e komunitetit shkollor apo dhe e institucioneve parashkollore, duke qëndruar së bashkë me fëmijët e tjerë në të njëjtat kopshte e shkolla.

Ajo i përshkruan me tone pozitive qëndrimet e bashkëmoshatarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte e shkolla, duke theksuar se ekziston një lloj pranimi personal dhe emocional ndaj fëmijëve me AK dhe se qëndrimet dhe sjellja e fëmijëve të tjerë është më pranuese dhe mbështetëse se ajo e shumë viteve më parë. Përfaqësuesja e drejtorisë arsimore të këtij qyteti sjellë një rast interesant për t'u vlerësuar në drejtim të tolerancës dhe mbështetjes që fëmijët e tjerë ofrojnë për shokët e tyre me AK.

Nxnësit e klasës së 5-të një shkolle 9-të vjeçare, të cilët kishin në klasë një fëmijë me probleme të theksuara motore, Ata kishin bërë një grafik përmes të cilit çdo njëri prej tyre e kishte të përcaktuar ditën se kur duhet të shoshoqëronte shokun për në shtëpi, për në shkollë, apo për në tualet. Kur shoku i tyre mungonte në shkollë për arsye shëndetësore, ata i shkonin në shtëpi për t' a ndihmuar në përgatitjen e detyrave.

Ajo parashtron edhe disa prej pengesave në zbatim të arsimit gjithëpërfshirës

1. Numri i madh i nxënësve për klasë dhe mungesa e një ndihmësi që do të përkushtohet tërësisht në zhvillimin e një ose dy fëmijëve që ata kanë në klasat e zakonshme bëjnë që vëmendja kundrejt kësaj kategorie fëmijësh të jetë minimale
2. Autorët e teksteve shkollore në konceptimin dhe hartimin e tyre nuk parashikojnë specifikisht edhe këtë kategori fëmijësh si nxënës; gjë që bën që gjatë procesit mësimor të shfaqen probleme dhe moskuptim i thellë, jo vetëm për fëmijët, por edhe për prindërit e tyre që përpiqen të japin kontributet e tyre pedagogjike në drejtim të kuptimit të koncepteve dhe krijimit të aftësive të caktuara. Kërkohet një nivel më i lartë psikologjik i autorëve të teksteve shkollore ose të konsiderohet si domosdoshmëri që në stafet e autorëve të teksteve shkollore të ketë edhe një specialist të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara (për moshat e vogla mungojnë ilustrimet tërheqëse, detyrat argëtuese që do të përfshin në mënyrë të natyrshme edhe këtë grup fëmijësh)
3. Vetë mësuesit jo gjithnjë janë të kualifikuar për punën me këta fëmijë. Mungesa e kualifikimit të


tyre në këtë fushë vështirëson jo vetëm marrëdhëniet mësimore dhe sociale me këta fëmijë, por shpesh edhe me prindërit e tyre që jo rrallë ngatërrojnë mungesën e dijeve të mësuesve me ndjenjën e përgjegjësisë së tyre të cilët e konsiderojnë të ulët, me paragjykime dhe shpesh edhe të dëmshme për zhvillimin e fëmijëve të tyre

4. Vlerësimi i arritjeve të këtyre nxënësve bëhet njëlloj si i të gjithë të tjerëve, gjë që shpesh krijon kontradikta mësues - drejtues, pasi në këto raste janë drejtuesit që nuk njohin si duhet punën që bëhet me fëmijët me nevoja të veçanta dhe kriteret e vlerësimit që duhet të përdoren me ta.

5. ANALIZA ETË DHËNAVE SASIORE

Pjesa deskriptive konsistoi në raportimin e frekuencave (numrat dhe përqindjet përkatëse) për variablet (ndryshorët) kategorike dhe raportimin e madhësive të prirjes qendrore dhe madhësive të dispersionit për variablet numerike.

Duke filluar prezantimin e të dhënave sasore, në Grafikon 1 pasqyrohet **ndarja e të intervistuarëve për realizimin e studimit në grupin e mësuesëve dhe bashkëmoshatarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla.**




Grafiku 1

Grafiku 1 tregon se në studim janë përfshirë 75 mësues të kopshteve dhe shkollave të përfshira në studim dhe 88 nxënës bashkëmoshatarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara që mësojnë në të njëjtat shkolla. Duhet theksuar se në studim janë përfshirë e shkolla në të cilat janë zbatuar projekte nga organizata të ndryshme lidhur me AGJ dhe shkolla, në të cilat nuk janë zbatuar projekte të kësaj natyre.


Grafiku 2

Ky grafik tregon përbërjen gjinore të mësuesëve të përfshirë në studim




Numri i lartë i mësueseve gra të përfshirë në studim rreth 65, mund të shpjegohet me faktin se në institucionet arsimore parashkollore ka vetëm mësuese gra, po kështu edhe numri i mësueseve gra në shkolla është më i madh kundrejt mësuesëve burra. Nga perspektiva gjinore kjo mund të shpjegohet me faktin se rolet gjinore ndikojnë në zgjedhjen e profesioneve, duke qënë se mësuesia është një profesion që lidhet më shumë me gratë për shkak të karakteristikave të saj.

Grafiku 3 pasqyron shpërndarjen e mësuesëve të përfshira në studim sipas rajoneve:



Vlen të theksohet se në studim janë përfshirë rajone në të cilat janë implementuar projekte për të zbatuar arsimin gjithëpërfshirës në kopshtet e shkolla nga organizata Save the Children siç janë Qytetet Tiranë, Korçë dhe Berat, por edhe qytete, në të cilët nuk janë implementuar projekte të kësaj natyre (qytetit i Laçit). Të dhënat e këtij grafiku pasqyrojnë shpërndarjen e mësuesëve të intervistuar në rajonet e lartpërmendura. (Janë përfshirë në studim 21 mësuesë në qytetin e Beratit, 20 në qytetin e Korçës, 25 në qytetin e Tiranës dhe 9 në qytetin e Laçit.




Grafiku 4

Në grafikun e mëposhtëm tregohet ndarja e punonjësve të arsimit të përfshirë në studim sipas institucioneve arsimore (institucione parashkollore dhe shkollore)

Grafiku 5

Më këtë grafik pasqyrohet informacioni lidhur me pasjen e njohurive të mësuesëve lidhur me arsimin gjithëpërfshirës.




59% e punonjësve të arsimit të intervistuar shprehen se kanë dëgjuar dhe kanë marrë informacion rreth arsimit gjithëpërfshirës dhe qëllimit të tij. Kjo bie ndesh me faktin se pavarësisht se një numër i konsiderueshëm mësuesish kanë informacionin e nevojshëm mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe fozozfisë së tij, një numër shumë i vogël vetëm 24% prej tyre aplikojnë PEI për fëmijët me ak dhe vetëm 26% e tyre përdorin teknika dhe praktika gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të orës së mësimi. Kjo mund të shpjegohet ose më faktin se për këta punonjës arsimit gjithëpërfshirës është vetëm një teori dhe jo diçka e zbatueshme në praktikë, ose me arsyen e thjeshtë se metodat tradicionale të e mësimdhënies **vazhdojnë të mbizotërojnë ende në kopshte e shkolla.**

Grafiku 6

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen burimet nga të cilat mësuesit kanë marrë informacionin e duhur rreth arsimit gjithpërfshirës dhe filozofisë së tij.


Sikurse vërehet edhe nga të dhënat e grafikut një numër i konsiderueshëm mësuesish e kanë marrë informacionin rreth politikës së arsimit gjithpërfshirës nga kurset e ndryshme të trajnimeve që janë organizuar nga shoqata të ndryshme apo dhe Ministria e arsimit dhe e Shkencës. Kështu trajnimet duket se janë mjete kryesor i shpërndarjes së informacioneve relevante tek punonjësit e arsimit



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet numri i mësuesëve, të cilët aplikojnë Plane edukative Individuale gjatë punës së tyre me fëmijët me aftësi të kufizuara,

Grafiku 7


Vetëm 24% e mësuesëve hartojnë dhe zbatojnë PEI për fëmijët me ak, në mënyrë që ata të kenë mundësi të përfshihen aktivisht në procesin mësimor. Kjo mund të shpjegohet me mungesën e aftësive profesionale për të hartuar e zbatuar Pei për fëmijët me ak, ose me mungesën e interesit lidhur me eliminimin e pengesave në mësimnxënie për këta fëmijë, me mungesën e kohës së mësuesëve etj.



Grafiku 8


Në këtë grafik jepet informacion lidhur me përdorimin ose jo të praktikave dhe metodave gjithpërfshirëse nga mësueset gjatë zhvillimit të orës së mësimt

Sikurse vërehet edhe nga grafiku vetëm 26% e mësuesëve që punojnë në kopshte e shkolla përdorin metoda dhe praktika gjithpërfshirëse në punën e tyre të përditshme me fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo mund të lidhet me faktin që vetëm pak mësues kanë rritur dhe zgjeruar kapacitetet e tyre profesionale në drejtim të punës me fëmijët me AK, ose shpjegohet me pritshmëritë e ulta dhe besimet e gabuara të punonjësve të arsimit në drejtim të arritjeve dhe zhvillimit të fëmijëve me ak.



Grafiku 9


Grafiku në vijim na prezanton një informacion mbi numrin e mësueseve që bashkëpunojnë me punonjëset e shërbimit psiko - social për të mbështetur dhe ndihmuar procesin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në jetën shkollore.



Sikurse vërehet nga të dhënat e grafikui vetëm 30% e mësueseve bashkëpunojnë me psikologët e kopshteve e shkollave për të realizuar procesin e gjithpërfshirjes së fëmijëve me ak në arsim. Në një kuptim më të gjerë, këto mësuese bashkëbisedojnë me psikologët, lejojnë pjesëmarrjen e tyre në orët mësimore dhe në aktivitetet jashtëshkollore që organizohen. kërkojnë ekspertizën e punonjësve të shërbimit psiko- social, ndajnë me to informacione për fëmijët me ak dhe pranojnë këshillat e sugjerimet e tyre.

Grafiku 10

Grafiku i mëposhtëm na mundëson informacion lidhur me mënyrat e punës në institucionet shkollore.




Edhe pse puna në ekip në ditët e sotme është një nga format më të mira dhe më bashkëkohore të punës, në institucionet arsimore duket se kjo mënyrë nuk aplikohet. Vetëm 5% e mësueseve të intervistuar kanë raportuar se punojnë në ekip, se diskutojnë me njëri - tjetrin rreth ecurisë dhe progresit të fëmijëve me AK, sfidat dhe vështirësitë që ata kanë në procesin e mësimnxënies, strategjitë e ndërhyrjes për të kapërcyer këto vështirësi, mënyrat dhe teknikat që rrisin pjesëmarrjen e këtyre fëmijëve në procesin mësimor.

Grafiku 11


Grafiku në vazhdim paraqet informacion lidhur me bashkëpunimin që kanë mësuesit me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Sikurse vërehet edhe nga të dhënat që tregohen në grafik duket qartë se vetëm 44% e mësuesëve kanë një marrëdhënie bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve me AK, që do të thotë se prindërit dhe mësuesit kanë kontakte të shpeshta dhe periodike, mbështesin punën e njëri - tjetrit dhe së bashku punojnë për të ndihmuar fëmijën në përvetësimin e programit mësimor dhe në procesin e socializimit të tij. Kjo nënkupton se pritshmëritë e prindërve dhe mësuesëve për shkollën dhe familjen, si dhe për arritjet e fëmijës me ak kanë pika të përbashkëta takimi, se niveli i ndërgjegjësimit të tyre për të siguruar një partneritet efektiv familje - shkollë është në nivel të lartë.



Grafiku 12


Në grafikun e mëposhtëm tregohet shpërndarja e nxënësve të intervistuar sipas rajoneve përkatëse.



Grafiku 13


Në këtë grafik jepet informacion lidhur me shpërndarjen gjinore të nxënësve që janë përfshirë në studim

Sikurse vërehet edhe nga të dhënat e grafikut janë më shumë vajza se djem të përfshirë në studim. Kjo mund të shpjegohet me faktin se ka një përqindje më të lartë të nxënësve vajza krahasuar me djem ose me faktin që vajzat janë më të gatshme të japin informacione



Grafiku 13


Në këtë grafik pasqyrohen mënyrat e sjelljes së fëmijëve ndaj bashkëmoshatrëve të tyre me AK lidhur me procesin e të ndihmës dhe mbështetjes që ata ofrojnë në përgjigje të nevojave të këtyre fëmijëve



Sikurse vërehet edhe nga të dhënat në grafikun e mësipërm një numër i konsiderueshëm fëmijësh rreth 68% e tyre i ndihmojnë dhe i mbështesin shokët e tyre me ak duke ju nxjerrë librat dhe mjetet e tjera nga çanta, duke i shoqëruar në tualet, duke i ndihmuar të mbajnë çantën, kujdesen për sigurinë e tyre, i ndihmojnë në bërjen e detyrave etj.

Grafiku 14


Grafiku në vijim pasqyron qëndrimet e bashkëmoshatarëve të fëmijëve me AK,



Duke ju refruar të dhënave që pasyrohen në grafik vërehet se fëmijët e tjerë mbajnë qëndrime pranuese e mbështetëse ndaj bashkëmoshatarëve të tyre me AK. Rreth 89% e tyre shprehen se nuk i paragjykojnë fëmijët për aftësinë e kufizuara që ata kanë, nuk i thërrasin me emra fyes apo tallës, nuk i mëshirojnë, janë tolerantë ndaj ndryshimeve që ekzistojnë midis tyre, pa folur shpesh për këto ndryshime .

Grafiku 15

Grafiku i mëposhtëm jep informacion rreth konsideratave që fëmijët e tjerë shprehin për bashkëmoshatarët e tyre me AK.



Sikurse vërehet edhe nga grafiku, më shumë se gjysma e fëmijëve të përfshirë në studim rreth 72% e tyre i vlerësojnë bashkëmshatarët e tyre me aftësi të kufizuara për vlerat dhe kapacitetet që ata kanë, pavarësisht diferencave që ekzistojnë midis tyre. Ata vlerësojnë aftësitë apo talentin e tyre në muzikë, në pikturë, punë me plastelinë.

Grafiku 16

Në vazhdim, edhe grafiku i mëposhtëm jep informacion rreth mënyrave të sjelljes dhe qëndrimit të fëmijëve ndaj bashkëmoshatarëve të tyre me AK


Pothuajse të gjithë fëmijët (93% e tyre) pranojnë të ulen në të njëjtat banka me shokët e tyre me AK, të bisedojnë me ata për gjëra të ndryshme, nuk shfaqin rezistencë nëse mësuesja i cakton në bankë një shok me AK ose ulen me dëshirë me ta.



Grafiku 17

Në grafikun e mëposhtëm jepet informacion lidhur me mënyrat se si fëmijët e tjerë pranojnë dhe mbështesin shokët e tyre në aktivitetet jashtë mësimit

85% e fëmijëve luajnë së bashku në grup apo në dyshe me bashkëmoshatarët e tyre me AK, pa i veçuar dhe diskriminuar ata, duke i trajtuar si të barabartë pavarësisht ndryshimeve që ata kanë, duke nxitur përfshirjen e tyre në lojëra dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre, pa i paragjykuar për mundësitë dhe aftësitë e tyre.



Një botë për të gjithë!



Konkluzione

- Fatkeqësisht politikat e ndjekura në të kaluarën në drejtim të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla speciale duket se edhe sot e minojnë procesin e arsimit gjithëpërfshirës.
- Ka mësues që mendojnë dhe besojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të vazhdojnë të arsimohen në shkolla speciale.
- Mungesa e vlerësimit sistematik të nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipe multidisiplinare ose qendra të specializuara ka bërë që fëmijët me AK të përballen me shumë sfida gjatë procesit të arsimit të tyre.
- Zbatimi i kuadrit ligjor ka ende shumë paqartësi në praktikën e përditshme.
- Ka mungesa të shumta të strukturave mbështetëse brenda strukturave të shkollave të arsimit bazë
- Fëmijët e tjerë janë pranues dhe mbështetës për shokët e tyre me AK, ata qëndrojnë me ta, i ndihmojnë, luajnë, nuk i paragjykojnë, janë tolerantë ndaj ndryshimeve që ekzistojnë midis tyre.
- Ka një problematikë të gjerë në fushën e zbatimit të AGJ: mungesa e fleksibilitetit të kurrikulës, mjeteve të posaçme didaktike, mungesa e mësuesëve të përgatitur dhe mbështetja e profesionistëve të tjerë të nevojshëm, si terapistë të foluri dhe psikologë e punonjës socialë.

Rekomandime

- Fëmijët me aftësi të kufizuara mësojnë nga njëri-tjetri në mjedise gjithëpërfshirëse, prandaj është e rëndësishme që qëndrimi dhe pozicioni i fëmijëve duhet të nxisë dhe të stimulojë përfshirjen e të gjithë fëmijëve në një aktivitet mësimor apo social.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara, kalojnë më pak kohë në bashkëveprimin dhe ndërveprimin me bashkëmohatarët e tyre, krahasuar me fëmijët e tjerë, prandaj është e rëndësishme që kjo kohë të shfrytëzohet maksimalisht për t'ju mësuar atyre koncepte dhe aftësi të reja në përshtatje me nivelin e tyre të zhvillimit.
- Konceptet që do t'u mësohen fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë nevojë të thjeshtëzohen sa më shumë të jetë e mundur.
- Është e nevojshme që mësueset fillimisht të përcaktojnë nevojat edukative të fëmijës, të përcaktojnë nivelin aktual të zhvillimit të tij, të përcaktojnë nivelin e përfshirjes së tij në aktivitetet mësimore dhe ato sociale dhe më pas të hartojnë planin e ndërhyrjes.
- Mësuesja duhet të identifikojë nëse fëmija shfaq vështirësi në sjellje, duhet të përzgjedhë aftësitë dhe konceptet që janë më të përshtatshme për t'u përvetësuar nga fëmija, duke marrë në konsiderat prioritetet dhe nevojat që fëmija ka.
- Mësueset duhet të përdorin përforsimin pozitiv kur fëmijët me aftësi të kufizuara arrijnë rezultatin e dëshiruar, por edhe kur nuk e arrijnë këtë rezultat ata duhet të stimulohen për përpjekjet e tyre.
- Mësueset duhet të promovojnë përfshirjen aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aktivitetet që zhvillojnë bashkëmohatarët e tyre gjatë programit mësimor dhe jashtë tij.
- Mësueset duhet të dinë se çdo fëmijë me aftësi të kufizuara ka ritmin e tij të zhvillimit dhe se ky ritëm varet shumë nga mundësitë dhe aftësitë që fëmija ka, por edhe nga stimulimi dhe inkurajimi i fëmijëve për të mësuar dhe përvetësuar aftësi dhe shprehje të reja.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të konsiderohen si fëmijët e tjerë dhe të ndihmohen për të marrë pjesë plotësisht (brenda nivelit që lejojnë zhvillimi dhe mundësitë e tyre) në të gjitha fushat e programit parashkollor. Për këtë mund të jetë e nevojshme që mjedisi i klasës ose aktivitetet të caktuara të modifikohen dhe të përshtaten për të mundësuar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara krahas bashkëmohatarëve të tyre.

- Fëmijët me AK, të cilët pavarësisht vështirësive dhe problemeve të ndryshme kanë kapacitete dhe aftësi që duhen identifikuar dhe nxitur, në mënyre që të përfshihen plotësisht në procesin mësimor dhe në jetën sociale.
- Mësueset duhet të planifikojnë dhe modifikojnë aktivitete në varësi të nevojave që kanë fëmijët në fushën e nxënjes, si dhe duke konsideruar pikat e forta të çdo fëmije, përfshi edhe ata me aftësi të kufizuara. Çdo mësuese ndërsa planifikon aktivitetet duhet t'i drejtojë vetes dhe kolegeve disa pyetje:
 - A mund të marrin pjesë të gjithë fëmijët në këtë aktivitet, si dhe në ç'mënyrë mund të arrihet kjo?
 - Si do të përfshihet një fëmijë me aftësi të kufizuara dëgjimi apo vizuale në këtë aktivitet?
 - Çfarë duhet përshtatur që fëmijët të rrisin aftësitë e tyre sensoriale?
 - Si mund të arrijë një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale të ketë një pjesëmarrje aktive në këtë apo atë aktivitet të planifikuar?
 - Si mund t'a planifikojmë kohën në mënyrë që në aktivitetet që zhvillohen në grup të marrin pjesë në mënyrë të sukseshme edhe fëmijët që kanë çrregullime të vëmendjes apo dhe probleme të sjelljes?
- Duhet të ngrihen dhe të konsolidohen ekipe multidisiplinare me bazë DAR-i dhe shkolle
- Duhet të rritet numri i punonjësve të shërbimit psiko - social në kopshte e shkolla
- Duhet të arrihet një bashkëpunim ndërsektorial me përfshirjen e institucioneve nga fusha e arsimit, shëndetësisë dhe asaj psiko - sociale
- Duhet vendosur ura bashkëpunimi midis familje sdhe shkollës
- Duhet e të vazhdojë rritja dhe zgjerimi i aftësive dhe kapaciteteve të punonjësve të arsimit përmes kurseve të trajnimit, shpërndarjes së materialeve informative deh replikimit të parktikave dhe modeleve më pozitive
- Është i nevojshëm hartimi dhe zbatimi i PEI për të mbështetur fëmijët me AK në procesin e mësimnxënies së tyre
- Duhet siguruar zbatimi i kuadrit ligjor nga autoritetet përgjegjëse.
- Duhet reduktuar niveli i stigmës dhe diskriminimit që ekziston për fëmijët me AK dhe arritjet e tyre përmes fushateve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere.
- Përmbajtja e kurrikulës, struktura e shkollës, infrastruktura, karakteristikat e vet nxënësve janë të gjitha parametra të lidhur bashkë për t'u konsideruar në zbatimin e çdo shkalle apo forme të arsimit gjithëpërfshirës
- Në hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave duhet të vendosen objektiva të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Po ashtu duhet të jepen edhe udhe udhëzime më specifike për vlerësimin e arritjeve të këtyre fëmijëve
- Vlerësimi i teksteve shkollorë fitues duhet të përfshijë edhe kriterin e përmbushjes së objektivave të arritjes për fëmijët me nevoja të veçanta. Tekstet shkollorë sidomos ato të ciklit fillor duhet të përmbajnë ilustrime vizatimore tërheqëse për moshën e fëmijëve duke i nxitur ata të mendojnë dhe të mësojnë konkretisht
- Të ngrihet një rrjet trajnerësh kombëtarë për përgatitjen e mësuesve në punën për fëmijët me nevoja të veçanta, por edhe për stafet e autorëve të teksteve shkollorë, shtëpive botuese, etj., në mënyrë që kurrikula dhe materialet e tjera ndihmëse të bëhen sa më efektive dhe të dobishme për nxënësit dhe prindërit e tyre
- Dokumentet kurrikularë në sistemin tonë shkollor duhet të përcaktojnë **qëllimet, objektivat dhe funksionet** e fushave të ndryshme të dijes në përgjigje të diversitetit mendor dhe fizik të nxënësve.

- Ato duhet të parashtrojnë **metodat** që duhet të përdoren për të vënë në jetë aftësitë e përgjithshme dhe komunikatave duke dhënë disa drejtime të operacioneve të mësim nxënies dhe mësimdhënies. Në këtë kontekst duhet që nxënësit të demonstrojnë përvetësimin e njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive apo të vlerave në përputhje me mundësitë potenciale të tyre,
- Objektivat e kurrikulës arsimore duhet të jenë një dokument i dobishëm në ndihmë të mësuesve, të hartuesve të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera ndihmëse në procesin mësimor; të specialistëve të vlerësimit, të institucioneve trajnuese dhe kualifikuese të mësuesve, prindërve, etj

